



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 70

Datë: 14. 12. 2017, ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Ilir Gashi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veselinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.68 dhe 69/2017

2. Raport nga SKQZ;

3. Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunave në Kllokot;

4. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- Këshillit për Çështje Ligjore

-Shqyrtimi dhe Miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prizren dhe në Viti

- Këshilli për Buxhet ;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transfer të mjeteve brenda programit të Zgjedhjeve,*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transfer të mjeteve brenda programit të Sekretariatit*

5. Të ndryshme;

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.68 dhe 69/2017

Valdete Daka: Atëherë, mirë se keni ardhur në mbledhjen e 70- të të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A ka dikush ndonjë vërejtje në lidhje me agjendën? Nëse jo kush është për këtë agjendë?

Pika e parë e mbledhjes, është shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet 68 dhe 69 të KQZ-së. A ka dikush vërejtje?

Nëse jo, kush është për miratimin e këtyre dy procesverbaleve?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan *procesverbalet nga mbledhjet nr.68 dhe 69/2017*

2. Raport nga SKQZ

Enis Halimi: Faleminderit kryetare, të nderuar anëtarë, Sekretariati ka vijuar me implementimin e planit operacional për zgjedhjet në komunën e Istogut, pra për përsëritjen e votimit. Deri më sot, janë kryer një mori punësh. Ka përfunduar procesi i shtypjes së listës votuese. Pra, lista votuese tash ka përfunduar, si të themi, mbikëqyrja e këtij procesi. Ky proces, ka përfunduar dhe tashmë listën votuese e kemi në depon tonë. Po ashtu, ka përfunduar edhe periudha për votim jashtë Kosovës. Ne, po vazhdojmë t'i pranojmë pakot me fletëvotime të supozuara, dhe deri më tani, pra deri dje, kemi pranuar gjithsej, 14 pako dhe që supozojmë se aty ka fletëvotime me qëllim të rivotimit të komunës së Istogut. Po ashtu, edhe për sa i takon kategorive tjera të personave të ngjuar në shtëpi dhe ata me lëvizje të kufizuar në institucione, ne i kemi ndërmarr të gjitha masat për regjistrimin e atyre votuesve dhe përgjithësisht, ka një evidencë korrekte të atyre dhe po bëjmë të gjitha përgatitjet e nevojshme që të realizohet edhe e drejta e tyre.

Gjithashtu, tha z. Halimi, janë zhvilluar gjithsej deri më tash 17 seanca të trajnimit me gjithsej 410 komisioner të trajnuar. Nesër do të procedohet edhe me trajnimin e 5 ekipeve. Për sa i takon Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, po i bëjmë përgatitjet tona në mënyrë që të dielën të procedojmë me pranim të materialit nga komuna e Istogut. Gjatë ditës së hënë, do të përfundojmë me procesin e regjistrimit dhe të pranimit të votave të çfarëdo kategorie qofshin ato. Po ashtu, është mbajtur edhe një takim me strukturat e sigurisë ditën e djeshme lidhur me zgjedhjet në Istog. Planifikojmë që ta mbajmë një takim nesër edhe me menaxherët e Qendrave të Votimit dhe kështu, besoj që e rrumbullakojmë gjithë procesin. Ngase, edhe fletëvotimet për këtë rivotim kanë ardhur dje dhe i kemi në depon tonë. Deri më tash, nuk kemi ndonjë vërejtje sinjifikante që, do t'ia vlente të theksohej këtu...

3. Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunave në Kllokot

Valdete Daka: Faleminderit krye shëf. A ka dikush vërejtje për këto zhvillime në Sekretariat? Nëse jo, vazhdojmë me pikën tjetër: certifikimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar Komune në Kllokot. Pra, mbasi që i kemi marr edhe njoftimin nga Gjykata Supremeve se pranë kësaj gjykate nuk ka ndonjë ankesë lidhur me komunën e Kllokotit, janë përmbushur të gjitha kushtet

ligjore që ne sot ti certifikojmë rezultatin për kryetarë komune, e fundit nga raundi i dytë. E keni para jush rezultatin, s'kemi nevojë me lexuar edhe një herë. Kush është për certifikimin e këtyre rezultateve?

Anëtarët e KQZ-së miratuan certifikimin e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar Komune në Kllokot

Valdete Daka: Faleminderit dhe, të njoftohet Ministria e Pushtetit Lokal. Vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ-ës.

4. Raport i Këshillave të KQZ-së:

1. Këshillit për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe Miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prizren dhe në Viti

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare. Këshilli për Çështje Ligjore, i ka propozuar Komisionit Qendror Zgjedhorë zëvendësimin e dy anëtarëve mbasi që shërbimi i ka analizuar të gjitha shënimet dhe të dhënat, dhe se konstaton se janë në rregull dhe i plotësojnë të gjitha kushtet. Këshilli, rekomandon që të bëhet zëvendësimi i dy anëtarëve" një në Prizren, dhe tjetri në Viti.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prizren dhe në Viti

5. Këshilli për Buxhet

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transfer te mjeteve brenda programit të Zgjedhjeve

Ilir Gashi: Faleminderit kryetare. Ju përsëndes të gjithëve, ne sot kemi mbajtur takimin e këshillit të buxhetit natyrisht kanë dalluar nga sekretariati dy kërkesa që do të kërkohet të bëhet transfer brenda njësisë të buxhetit. Natyrisht obligimet që dalin nga ne si institucion për ti kryer karshi njerëzve të cilët kanë punuar në procesin zgjedhor, kërkohet që për pagesat në programin e zgjedhjeve 14200 është një shumë për 1 421529.88 euro. Këto obligime kanë të bëjnë me pagesat për muajin dhjetor të stafit të KKZ-ës trajnerëve dhe gjithashtu pagesat e KVV-e raundi i dytë dhe K-Votës raundi i dytë, po shtuar stafit të QNR-ës në raundin e dytë , KVV-e rivotimin në Istog dhe K-votës rivotimi në Istog. Me këtë program me kodin 13460 nuk ka pasur mjete të mjaftueshme për këto pagesa. Shuma aktuale me këtë kod është 71357.03 euro, prandaj kërkohet transfer nga 25 kode të cilat i kemi edhe në tabelën e paraqitur. Shuma e cila kërkohet të transferohet nga këto kode në kodin 13460 është një vlerë prej 123249 euro. Disa prej transferove të kërkuara e tejkalojnë edhe buxhetin prej 25% të nënkategorisë ekonomike sipas nenit 18.4 të ligjit të buxhetit. Për këto transfere duhet të kërkohet edhe miratimi natyrisht të ministrisë së financave andaj kërkohet nga ne që ta miratojmë këtë transfer.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kërkesën për transfer të mjeteve brenda programit të Zgjedhjeve.

Valdete Daka: A ka dikush diçka? Kush është për? Faleminderit. E kemi edhe një pikë....

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për transfer të mjeteve brenda programit të Sekretariatit

Ilir Gashi: Po ashtu, e kemi edhe një transfer që është një shumë shumë e vogël por, që është e domosdoshme përbrenda Sekretariatit. Është në kodin 13130. Shuma totale, është prej 6250 euro.

Valdete Daka: Kush është për? Faleminderit. A kemi diçka tjetër? Nëse jo Faleminderit.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kërkesën për transfer të mjeteve brenda programit të Sekretariatit.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
